

“NDIKIMI I FITOHOROMONEVE DHE MIKORIZËS NË SHUMIMIN VEGJETATIV ME COPA TË RRËNJËVE TE MJEDRA (RUBUS SP.)”

ABSTRAKTI

Prodhimi i fidanëve cilësor është një prej hallkave kryesore të prodhimit të pemëve në këtë rast mjedrës. Përzgjedhja e mënyrës dhe teknikave të prodhimit të fidanëve e lehtëson dhe e ndihmon zhvillimin e kulturës së mjedrës në përgjithësi. Ky studim ka për qëllim të vë në pah ndikimin e disa faktorëve në prodhimin e fidanëve të mjedrës përmes teknikës së copave të rrënjëve. Në këtë rast janë hulumtuar faktorët gjenetik përmes duke testuar 4 kultivarë të mjedrës (Wilamet, meeker, Mapema dhe Delniva) si dhe përdorimi i simulantëve të rrënjëzimit (fitohormonit auksinë, acidit indol butirik – IBA dhe mikorizës – produktit Myco Apply). Studimi është kryer gjatë vitit 2022 një eksperiment të shtruar posaçërisht për këtë hulumtim. Materiali – bimët mëmë janë marrë në komunën e Podujevës të disa fermer prodhues të mjedrës. Rëndësia e këtij studimi qëndron se mund të analizojmë taktiken e shumimit vegjetativ të mjedrës me copa të rrënjëve të kultivarëve të ndryshëm duke përdorur simulantë të ndryshëm. Pas përfundimit të studimit kemi vërejtur se prodhimi i suksesshëm i fidanëve përmes copave të rrënjëve varet gjithësesi nga kultivari ku në rastin tonë kultivari më i suksesshëm është treguar Mapema ndërsa më i dështuar Meekeri. Po ashtu edhe tretmanët me IBA dhe mikorizë kanë shfaqë ndikim domethënës si në përqindjen e fidanëve të zhvilluar ashtu edhe në parametrat cilësor të fidanit.

Fjalët kyçe : Mjedra, fidani, shumim kultivari, IBA, mikoriza.

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Flaktrim Rrahimi